

Ftesë për praktikantë

Eduktor/e për programe me nxënës të shkollave fillore

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës i fton të interesuarit të aplikojnë për në pozitën e Praktikantit Edukator, gjatë periudhës 1 mars-10 qershor 2016. Praktikantët do të jenë të kyçur në pilot programin e arsimit tërë ditor në tri shkolla fillore të Komunës së Prishtinës.

Ata do të kenë mundësi të trajnohen në aftësi të reja të edukimit interaktiv, që është një metodë e vlerësuar dhe kërkuar nga edukatorët dhe mësuesit modern.

Praktika është pa pagese, por pas përfundimit të praktikës, praktikantët do të pranojnë një vërtetim dhe mirënjohje nga Drejtoria e Arsimit për punën e bërë. Praktikantët më të mirë do të konsiderohen si kandidatë prioritarë për vende të punës në OJQ "TOKA", e cila është partnere e Drejtorisë së Arsimit në këtë projekt.

Detyrat

- Asistencë në realizimin e programeve edukative në mënyrë që nxënësit të marrin pjesë me entuziazëm në aktivitetet e parapara;
- Krijimi i një atmosfere pozitive të të mësuarit gjatë programeve edukative,
- Nxitja e mësimit tek nxënësit nëpërmes prezantimeve, diskutimeve dhe aktiviteteve grupore;
- Observimi i vëmendshëm i performancës së nxënësve, sjelljes dhe zhvillimit social të tyre;
- Mbikëqyrja e nxënësve, që të kenë siguri dhe mirëqenie gjatë kohëzgjatjes së programeve.

Kualifikimet

- I/e diplomuar ose absolvent/ në shkenca sociale (drejtimi arsimor);
- I/e adaptueshëm të punojë në rrethana të ndryshueshme;
- Gatishmëri për të punuar në mënyrë të pavarur, ashtu dhe në një mjedis ekipor;
- Bashkëpunues/e me një qëndrim pozitiv, entuziazëm, profesionalizëm dhe etikë të lartë pune;
- Aftësitë e komunikimit në gjuhën angleze janë të mirëseardhura.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë CV-në dhe Letër Motivimi

Afati dhe mënyra e aplikimit: Konkursi mbetet i hapur 7 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me: 10.02.2015 gjer më datën 16.02.2016.

Aplikacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.